




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.2, datë 28.05.2025



PËR
RINOVIMIN E LEJES ME NR. 299/1, DATË 11.2.2020 DHËNË ME
VENDIM NR.1 DATË 7.2.2020 NGA KBU SEMAN
“PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË
AMBALAZHUAR”,
SUBJEKTIT “DALIP HADO”SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 141, të ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore”, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes me nr.299/1, datë 11.2.2020 dhënë me vendim nr.1 datë 7.2.2020 nga KBU Seman për “Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar” subjektit “Dalip Hado”sh.p.k me vendndodhje Njësia Administrative Vithkuq Korçë:
2. Treguesit parapрак janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për burimin sipas KRGJSH

- X= 544589.553 ; Y= 4487847.434 ; Z= 1478 m.m.n.d



- Prurja e kërkuar: $Q = 0.001 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

ARBEN ÇUKO

